



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA FIER
DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. 1110 Prot.

Fier më 24/01/2025

PROJEKT VENDIM

NR. 16 dt. 24/01/2025

“Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesës e cila ka mbetur pa u regjistruar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, për lidhjen e Kontratës para noterit”

Këshillit të Bashkise Fier, sot më dt.../01/2025, i paraqitet për shqyrtim materiali nga Drejtoria Juridike, mbi kërkesën zyrtare të familjes që kërkon përfundimin e procedurës së privatizimit të banesës e cila ka mbetur pa u regjistruar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, (ish ZVRPP Fier) për shkak të lidhjes së kontratës të privatizimit para noterit.

Dokumentacioni ligjor i privatizimit u është vënë në dispozicion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier në formën fotokopje e cila administrohet në arkivën pranë kësaj drejtorie, si dhe është plotësuar me dokumentacionin ligjor të rifreskuar kartela e pasurisë së paluajtshme dhe fragmenti i hartës kadastrale.

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 97 datë 03.02.2008 " Për procedurat e privatizimit të banesave shtetërore objekt i ligjit nr. 7652 datë 23.12.1992 dhe ligjit nr.9321 date 25.11.2004 "Per trajtimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e Shoqërive dhe Ndërmarrjeve Shtetërore " dispozitave ligjore nenet 192,193 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, si dhe Ligjin Nr.111/2018“Për Kadastrën”, ekzekutivi :

Propozon

1.Miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të apartamentit, përkatesisht lidhjen e kontratës të shitblerjes para Noterit, të banesës e cila ka mbetur pa u regjistruar pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, për familjen si më poshtë:

Nr.	Emër-Mbiemer	Pasuria / Adresa
1	Flamur Feçor Ferko Burbuqe Qamil Ferko	Kartela e Pasurisë së paluajtshme /Fragment I Hartës Kadastrale

		Nr.i Pasurisë 15/6+1-1 lloji "Apartament " ZK Nr.8531,përbërje 1+1 , sip.61.2 m2
--	--	---

- 2.Shpenzimet noteriale dhe tarifat për veprimet e regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore , do të kryhen nga familja përfituese.
- 3.Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Fier, ose personi i autorizuar prej tij, për lidhjen e kontratës para noterit publik.

*Konc.Drejtoria Juridike
Esmeralda Kapllanaj*

KRYETAR
Armando Subashi

NË MUNGESË ME AUTORIZIM

Sekretari i Përgjithshëm
Martin Dodi

